



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RREGULLORE (AAC) NR. 01/2026 MBI RREGULLAT DHE PROCEDURAT E OPERIMEVE TË
SISTEMEVE TË MJETEVE AJRORE PA PILOT**

**REGULATION (CAA) NO. 01/2026 ON THE RULES AND PROCEDURES FOR OPERATION OF
UNMANNED AIRCRAFT SYSTEMS**

**UREDBA (ACV) BR. 01/2026 O PRAVILIMA I POSTUPCIMA ZA UPRAVLJANJE SISTEMIMA
BESPILOTNIH LETELICA**

<p>Në përputhje me nenin 3.4, nenin 15.1 pikat (a), (c), (d), (j) dhe nenin 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),</p> <p>Duke marrë parasysh:</p> <p>Rregulloren (AAC) Nr. 05/2020, të datës 30 tetor 2020 për zbatimin në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregullorja (BE) 2018/1139 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 4 korrik 2018 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe për themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit, si dhe për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 10/2015 dhe Rregullores (AAC) Nr. 9/2017 dhe për shfuqizimin e Rregullores (AAC) Nr. 11/2009, Rregullores (AAC) Nr. 3/2009 dhe Rregullores (AAC) Nr. 6/2009,</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:</p> <p>Rregullore (AAC) nr. 01/2026 mbi rregullat dhe procedurat e operimeve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot</p>	<p>Pursuant to Article 3.4, 15.1 items (a), (c), (d), (j) and 21.2 of the Law No. 03/L-051 on Civil Aviation (“Official Gazette of the Republic of Kosovo” Year III, No. 28, 4 June 2008),</p> <p>Taking into consideration,</p> <p>Regulation (CAA) No. 05/2020 of 30 October 2020 implementing into the internal legal order of the Republic of Kosovo, Regulation (EU) 2018/1139 of the European Parliament and of the Council of 4 July 2018 on common rules in the field of civil aviation and establishing a European Union Aviation Safety Agency and amending Regulation (CAA) No. 10/2015, Regulation (CAA) No. 9/2017 and repealing Regulation (CAA) No. 11/2009, Regulation (CAA) No. 3/2009 and Regulation (CAA) No. 6/2009,</p> <p>Director General of Civil Aviation Authority of the Republic of Kosovo, hereby issues the following:</p> <p>Regulation (CAA) No. 01/2026 on the rules and procedures for operation of unmanned aircraft systems</p>	<p>U skladu sa članom 3.4, 15.1 tačkama (a), (c), (d), (j) i 21.2 Zakona br. 03/L-051 o civilnom vazduhoplovstvu („Službeni glasnik Republike Kosovo“, godina III, br. 28, 4. jun 2008. godine),</p> <p>Uzimajući u obzir,</p> <p>Uredbu (ACV) br. 05/2020 od 30. oktobra 2020. godine kojom se u unutrašnji pravni poredak Republike Kosovo sprovodi Uredba (EU) 2018/1139 Evropskog parlamenta i Saveta od 4. jula 2018. godine o zajedničkim pravilima u oblasti civilnog vazduhoplovstva i osnivanju Agencije Evropske unije za bezbednost vazduhoplovstva i o izmeni Uredbe (ACV) br. 10/2015, Uredbe (ACV) br. 9/2017 i stavljanjem van snage Uredbe (ACV) br. 11/2009, Uredbe (ACV) br. 3/2009 i Uredbe (ACV) br. 6/2009,</p> <p>Generalni Direktor Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Republike Kosova, ovim izdaje sledeću:</p> <p>Uredba (ACV) br. 01/2026 o pravilima i postupcima za upravljanje sistemima bespilotnih letelica</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p>	<p style="text-align: center;">Član 1 Svrha</p>
<p>Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi i aktiviteteve të aviacionit që lidhen me Sistemet e Mjeteve Ajrore pa Pilot (SAP) që operojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, si dhe zhvillimi dhe lehtësimi i aktiviteteve të SAP, duke siguruar kushte të pranueshme për operim të sigurt.</p>	<p>The objective of this Regulation is the regulation of aviation activities related to Unmanned Aircraft Systems (UAS) operating in the airspace of the Republic of Kosovo and developing and facilitating the UAS activities while providing acceptable conditions for safe operation.</p>	<p>Cilj ove uredbe je regulisanje vazduhoplovnih aktivnosti vezanih za sistemima bespilotnih letelica (SBL) koje operiraju u vazdušnom prostoru Republike Kosovo i razvoj i olakšavanje aktivnosti SBL-a, uz obezbeđivanje prihvatljivih uslova za bezbedan rad.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Zbatueshmëria</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Applicability</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Primenljivost</p>
<p>2.1 Kjo Rregullore përcakton dispozitat e detajuara për operimin e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP), kategorizimin dhe regjistrimin e tyre, si dhe për personelin, duke përfshirë pilotët në distancë dhe organizatat e përfshira në këto operime, brenda territorit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>2.1 This Regulation lays down the detailed provisions for the operation of unmanned aircraft systems (UAS), their categorization, registration, as well as for personnel, including remote pilots and organisations involved in those operations, within the territory of the Republic of Kosovo.</p>	<p>2.1 Ova uredba utvrđuje detaljne odredbe za rad sistemima bespilotnih letelica (SBL), njihovu kategorizaciju, registraciju, kao i za osoblje, uključujući daljinske pilote i organizacije uključene u te operacije, na teritoriji Republike Kosovo.</p>
<p>2.2 Kjo Rregullore nuk zbatohet për:</p> <p>(a) SAP me masë maksimale në ngritje (MTOM) më të vogël se 250 gr, ose, me kusht që shpejtësia maksimale të mos tejkalojë 19 m/s, operatori ta mbajë SAP-in brenda rrezes 15 m dhe në lartësi maksimale 30 m mbi nivelin e tokës (AGL),</p>	<p>2.2 The present Regulation shall not apply to:</p> <p>(a) UAS having the maximum take-off mass (MTOM) less than 250 gr. or, provided that the maximum speed does not exceed 19 m/s, the operator keeps the UAS in the range of 15 m and maximum altitude of 30 m above ground level (AGL),</p>	<p>2.2 Ova uredba se ne primenjuje na:</p> <p>(a) SBL sa maksimalnom poletačkom masom (MTOM) manjom od 250 gr. ili, pod uslovom da maksimalna brzina ne prelazi 19 m/s, operater drži bespilotnu letelicu u dometu od 15 m i na maksimalnoj visini od 30 m iznad nivoa tla (AGL),</p>

<p>(b) SAP me masë maksimale në ngritje (MTOM) mbi 150 kg, meqenëse në këto raste zbatohen dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 05/2020,</p> <p>(c) SAP të përdorura nga organet e zbatimit të ligjit, mbrojtjes ose sigurisë së brendshme, si dhe për shërbime zjarrfikëse, kërkim-shpëtim dhe shërbime të tjera emergjente të njohura, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime.</p>	<p>(b) UAS with a maximum take-off mass (MTOM) exceeding 150 kg. as in such cases the provisions of the Regulation (CAA) No. 05/2020 shall apply,</p> <p>(c) UAS used by law enforcement, defence or internal security agencies as well as fire-fighting, search and rescue and related recognized emergency services, Pursuant to the Law No. 03/L-051 on Civil Aviation, as amended.</p>	<p>(b) SBL sa maksimalnom masom poletanja (MTOM) većom od 150 kg, jer se u takvim slučajevima primenjuju odredbe Uredbe (ACV) br. 05/2020,</p> <p>(c) SBL koje koriste agencije za sprovođenje zakona, odbranu ili unutrašnju bezbednost, kao i vatrogasne službe, službe za potragu i spasavanje i srodne priznate službe za hitne slučajeve, u skladu sa Zakonom br. 03/L-051 o civilnom vazduhoplovstvu, sa izmenama i dopunama.</p>
<p>Neni 3 Përkufizimet</p>	<p>Article 3 Definitions</p>	<p>Član 3 Definicije</p>
<p>Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e përdorur kanë këtë kuptim:</p>	<p>For the purpose of the present Regulation, the definitions used herein shall have the following meaning:</p>	<p>Za potrebe ove uredbe, definicije koje se ovde koriste imaju sledeće značenje:</p>
<p>“mjet ajror” - nënkupton çdo mjet që fluturon në ajër nga reaksionet e ajrit, përveç reaksioneve të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës;</p>	<p>“aircraft” - means any machine that can derive support in the atmosphere from the reactions of the air other than the reactions of the air against the earth’s surface.</p>	<p>„vazduhoplov“ - znači bilo koja mašina koja može da se drži u atmosferi zahvaljujući reakcijama vazduha, osim reakcija vazduha na površinu Zemlje.</p>
<p>“leje e KTA-së” - nënkupton pëlqimin zyrtar me shkrim ose me email nga njësia e Kontrollit të Trafikut Ajror;</p>	<p>“ATC permission” - means a formal written or email consent from the Air Traffic Control Unit;</p>	<p>„ATC dozvola “ - znači formalna pisana ili imejl saglasnost Jedinice kontrole letenja;</p>
<p>“objekte ndihmëse komerciale” - nënkuptojnë hangarët, lokacionet e deponive</p>	<p>“commercial facilities” - means stables, garbage disposal locations, barns, storages,</p>	<p>„komercijalni objekti“ - znači štale, mesta za odlaganje smeća, ambare, skladišta itd.;</p>

<p>të mbeturinave, hambarët, depot, etj.;</p> <p>“operim përtej vijës së drejtë të shikimit” (‘BVLOS’) - nënkupton llojin e operimit me SAP që nuk kryhet në VLOS;</p> <p>“AAC” - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, të themeluar sipas Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil;</p> <p>“hapësira ajrore e kontrolluar” - nënkupton një hapësirë ajrore të kufizuar, në të cilën kryhet kontrolli i trafikut ajror për fluturimet IFR dhe VFR në përputhje me dispozitat për këtë klasë të veçantë të hapësirës ajrore;</p> <p>“operimet e fluturimit” - nënkupton operimet e sistemit të mjeteve ajrore pa pilot, pavarësisht se a kryhen ato për përfitime apo jo, ku mjeti ajror pa pilot përdoret për shërbime ajrore (d.m.th. incizime ajrore, reklama ajrore, mbikëqyrje ajrore, mbrojtje nga zjarri, fluturime shkencore e hetimore, fluturime për nevoja të mediave, ngjarje të veçanta, shfaqje ajrore, fluturime garuese, etj.);</p> <p>“tubime të njerëzve” - nënkupton një vend ku njerëzit mbledhen ose grumbullohen. Tubimet ndahen në ato publike me ç’rast aplikohen edhe njoftimet paraprake të autoriteteve përkatëse (shembull: demonstrata, koncerte,</p>	<p>etc.;</p> <p>“beyond visual line of sight operation”- (‘BVLOS’) means a type of UAS operation which is not conducted in VLOS;</p> <p>“CAA” - means the Civil Aviation Authority of the Republic of Kosovo established pursuant to the Law No. 03/L-051 on Civil Aviation, as amended;</p> <p>“controlled airspace” - means a delimited airspace in which air traffic control is carried out for IFR and VFR flights in accordance with the provisions for this specific class of airspace;</p> <p>“flight operations” - means operations of unmanned aircraft system, irrelevant whether they are conducted for remuneration or not, where the unmanned aircraft is used for air services (i.e. air filming, aerial advertising, air oversight, fire protection, scientific-investigation flights, flights for media needs, special events, air shows, competition flights, etc.);</p> <p>“gatherings of people” - means a place where people gather or congregate. Gatherings are divided into those of public gatherings where preliminary notifications apply to relevant authorities (example: demonstrations,</p>	<p>„Rad van vizuelne linije vida“- („BVLOS“) označava vrstu rada SBL koja se ne izvodi u VLOS-u;</p> <p>„ACV“ - označava Autoritet civilnog vazduhoplovstva Republike Kosovo osnovanu u skladu sa Zakonom br. 03/L-051 o civilnom vazduhoplovstvu, sa izmenama i dopunama;</p> <p>„kontrolisani vazdušni prostor“ - znači ograničeni vazdušni prostor u kome se vrši kontrola vazdušnog saobraćaja za IFR i VFR letove u skladu sa odredbama za ovu specifičnu klasu vazdušnog prostora;</p> <p>„letačke operacije“ - označava operacije bespilotnih letelica, bez obzira da li se obavljaju uz naknadu ili ne, gde se bespilotna letelica koristi za vazdušne usluge (npr. snimanje iz vazduha, reklamiranje iz vazduha, nadzor vazdušnog prostora, protivpožarna zaštita, naučno-istraživački letovi, letovi za potrebe medija, specijalni događaji, aeromitingi, takmičarski letovi itd.);</p> <p>„okupljanja ljudi“ - znači mesto gde se ljudi okupljaju ili sastaju. Okupljanja se dele na javna okupljanja gde se prethodna obaveštenja dostavljaju nadležnim organima (primer: demonstracije, koncerti itd.) i privatna</p>
---	--	---

<p>etj.) si dhe tubimet private (shembull: dasma, festa, shfaqje, etj.);</p> <p>“KFOR” – nënkupton Forcën e Kosovës, mision paqeruajtës ndërkombëtar i udhëhequr nga NATO dhe operacione mbështetëse ushtarake në Kosovë;</p> <p>“komisioni i ankesave – nënkupton një strukturë të ndarë dhe e pavarur nga strukturat tjera të AAC-së me qëllim të krijimit të mundësisë për kundërshtim të një veprimi, mosveprimi ose lëshimi procedural administrativ brenda AAC-së;</p> <p>“operator” – nënkupton personin, organizatën apo ndërmarrjen e angazhuar, apo e cila synon të angazhohet, në operimet me mjete ajrore;</p> <p>“pesha e operimit” - nënkupton peshën totale të mjetit ajror pa pilot në momentin e ngritjes;</p> <p>“pilot në komandë” - nënkupton personin fizik përgjegjës për kryerjen e sigurt të fluturimit të mjetit ajror pa pilot, duke operuar komandat e fluturimit, qoftë manualisht ose, kur fluturimi është automatik, duke monitoruar trajektoren dhe duke qenë i gatshëm të ndërhyjë dhe ta ndryshojë atë në çdo kohë;</p> <p>“mjet ajror pa pilot” – nënkupton çdo mjet</p>	<p>concerts, etc.) and private gatherings (example: weddings, shows, celebrations, etc.);</p> <p>“KFOR” - means Kosovo Force, a NATO-led international peacekeeping force and military support operations in Kosovo;</p> <p>“appeals commission” - means a separate and independent structure from other CAA structures in order to establish the possibility of a objecting an action, inaction or omission from an administrative procedure within the CAA;</p> <p>“operator” - means a person, organization or enterprise engaged in or offering to engage in an aircraft operation;</p> <p>“operating weight” - means total weight of unmanned aircraft at the moment of take-off;</p> <p>“remote pilot” - means a natural person responsible for safely conducting the flight of an unmanned aircraft by operating its flight controls, either manually or, when the unmanned aircraft flies automatically, by monitoring its course and remaining able to intervene and change the course at any time;</p> <p>‘unmanned aircraft’ - means any aircraft</p>	<p>okupljanja (primer: vençanja, predstave, proslave itd.);</p> <p>„KFOR“ - znači Kosovske snage, međunarodne mirovne snage pod vođstvom NATO-a i operacije vojne podrške na Kosovu;</p> <p>„komisija za žalbe“ - znači odvojena i nezavisna struktura od drugih struktura ACV-a kako bi se utvrdila mogućnost prigovora na radnju, neradnju ili propust iz administrativnog postupka unutar ACV;</p> <p>„operator“ - znači lice, organizacija ili preduzeće koje se bavi ili nudi da se bavi operacijom vazduhoplova;</p> <p>„radna težina“ - znači ukupna težina SBL u trenutku poletanja;</p> <p>„daljinski pilot“ - označava fizičko lice odgovorno za bezbedno sprovođenje leta SBL upravljanjem njenim komandama leta, bilo ručno ili, kada bespilotna letelica leti automatski, praćenjem njene kursne putanje i mogućnošću da interveniše i promeni kurs u bilo kom trenutku;</p> <p>“bespilotna letelica” - znači svaki</p>
--	--	--

<p>ajor që operon ose është projektuar të operojë në mënyrë autonome ose të pilotohet në distancë, pa pilot në bord;</p> <p>“hapësira për fluturimin me SAP” - nënkupton hapësirën ajrore brenda së cilës kryhet fluturimi i mjeteve ajrore pa pilot;</p> <p>“vija e drejtë vizuale” (‘VLOS’) - nënkupton operimin në të cilin pilot në komandë mban kontakt të drejtpërdrejtë vizual me mjetin ajror për ta menaxhuar fluturimin dhe për t’i përmbushur përgjegjësitë për ndarje dhe shmangie të përplasjeve me mjete tjera ajrore, njerëz dhe pengesave me qëllim të shmangjes të përplasjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Kategorizimi i SAP</p> <p>SAP ndahen në kategoritë vijuese:</p> <p>a) Kategoria A1 - përfshin SAP me peshë operative nga 250 gr deri në 1 kg dhe me shpejtësi maksimale ajrore jo më të madhe se 19 m/s.</p> <p>b) Kategoria A2 - përfshin SAP me peshë operative nga 1 kg deri në 4 kg dhe me shpejtësi maksimale ajrore jo më të madhe se 21 m/s.</p>	<p>operating or designed to operate autonomously or to be piloted remotely without a pilot on board;</p> <p>“UAS flying area” - means an airspace within which the flight of unmanned aircraft is conducted;</p> <p>“visual line of sight” (‘VLOS’) means a type of operation in which, the remote pilot is able to maintain continuous unaided visual contact with the unmanned aircraft, allowing the remote pilot to control the flight path of the unmanned aircraft in relation to other aircraft, people and obstacles for the purpose of avoiding collisions.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Categorisation of UAS</p> <p>UAS are divided into the following categories:</p> <p>a) Category A1 - includes UAS whose operating weight is from 250gr. up to 1kg. and maximum airspeed not exceeding 19 m/s.</p> <p>b) Category A2 - includes UAS whose operating weight is from 1 kg up to 4 kg. and maximum airspeed not exceeding 21 m/s.</p>	<p>vazduhoplov koji radi ili je projektovan za autonomni rad ili za daljinsko upravljanje bez pilota u letelici/vazduhoplovu;</p> <p>„Područje za letenje SBL“ - znači vazdušni prostor unutar kojeg se izvodi let bespilotnih letelica;</p> <p>„vizuelna linija vida“ (‘VLOS’) znači tip rada SBL u kojem je daljinski pilot u stanju da održava kontinuirani vizuelni kontakt bez pomoći sa bespilotnom letelicom, omogućavajući daljinskom pilotu da kontroliše putanju leta SBL u odnosu na druge letelice, ljude i prepreke radi izbegavanja sudara.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Kategorizacija SBL</p> <p>SBL su podeljene u sledeće kategorije:</p> <p>a) Kategorija A1 - uključuje SBL čija je operativna težina od 250 gr do 1 kg i maksimalna brzina vazduha ne prelazi 19 m/s.</p> <p>b) Kategorija A2 - uključuje SBL čija je operativna težina od 1 kg do 4 kg i maksimalna brzina ne veća od 21 m/s.</p>
---	--	--

<p>c) Kategoria A3 - përfshin SAP me peshë operative nga 4 kg deri në 25 kg dhe me shpejtësi maksimale ajrore jo më të madhe se 27 m/s.</p> <p>d) Kategoria A4 - përfshin SAP me peshë operative nga 25 kg deri në 150 kg dhe me shpejtësi maksimale ajrore jo më të madhe se 36 m/s.</p> <p>Nëse pesha e operimit ose shpejtësia ajrore e një fluturakeje pa pilot përputhet me dy kategori të ndryshme, SAP kategorizohet në kategorinë më të lartë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Klasifikimi i hapësirave të operimit me SAP</p> <p>Zonat e fluturimit të SAP, në varësi të nivelit të ndërtimit, numrit të popullsisë dhe pranisë së njerëzve, ndahen në klasat e mëposhtme:</p> <p>a) Klasa I - zonë e pandërtuar, pa objekte apo struktura të ngritura dhe pa prani njerëzish, përveç pilotit dhe personelit të nevojshëm për kryerjen e fluturimit;</p> <p>b) Klasa II - zonë e zhvilluar, e pabanuar, me objekte ndihmëse komerciale ose struktura që nuk janë të destinuara për banim, ku nuk ka prani njerëzish, përveç pilotit dhe</p>	<p>c) Category A3 - includes UAS whose operating weight is from 4kg up to 25 kg, and maximum airspeed not exceeding 27 m/s.</p> <p>d) Category A4 - includes UAS whose operating weight is from 25 kg up to 150 kg, and maximum airspeed not exceeding 36 m/s.</p> <p>If the operating weight or airspeed of an unmanned aircraft belongs to two different categories, UAS shall be categorised belonging to a higher category.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Classification of UAS flying areas</p> <p>UAS flight areas, depending on construction development, population number and presence of people, are divided in following classes:</p> <p>a) Class I - is non-constructed area with no erected constructions of facilities and with no people, apart from pilot and personnel required for flying;</p> <p>b) Class II - is developed uninhabited area with auxiliary commercial facilities or constructions which are not intended for habitation, where there are no people, apart</p>	<p>c) Kategorija A3 - uključuje SBL čija je operativna težina od 4 kg do 25 kg, a maksimalna brzina ne prelazi 27 m/s.</p> <p>d) Kategorija A4 - uključuje SBL čija je operativna težina od 25 kg do 150 kg, a maksimalna brzina ne prelazi 36 m/s.</p> <p>Ako operativna težina ili brzina SBL pripada dvema različitim kategorijama, SBL će biti kategorisana kao viša kategorija.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Klasifikacija područja leta SBL</p> <p>Područja leta SBL, u zavisnosti od razvoja gradnje, broja stanovnika i prisustva ljudi, podeljena su u sledeće klase:</p> <p>a) Klasa I - je neizgrađena površina bez podignutih konstrukcija ili objekata i bez ljudi, osim pilota i osoblja potrebnog za letenje;</p> <p>b) Klasa II - je izgrađeno nenaseljeno područje sa pomoćnim komercijalnim objektima ili građevinama koje nisu namenjene za stanovanje, gde nema ljudi,</p>
--	--	---

<p>personelit të nevojshëm për fluturimin;</p> <p>c) Klasa III - zonë e banuar me objekte ose struktura të destinuar kryesisht për banim, veprimtari afariste ose rekreacion (ndërtesa banimi, shtëpi banimi, shkolla, zyra, parqe, etj.);</p> <p>d) Klasa IV - zonë me dendësi të lartë të popullsisë, që përfshin zona të ngushta urbane (qendra qyteti, tubime me numër të madh njerëzish, etj.).</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Kushtet e përgjithshme të operimit me SAP</p> <p>6.1 Pronari ose operatori i SAP-it, gjatë fluturimit, duhet ta mbajë SAP-in brenda lartësisë maksimale prej 120 m mbi nivelin e tokës.</p> <p>6.2 Pronari ose operatori i SAP-it është përgjegjës që fluturimet të kryhen në përputhje me këtë Rregullore.</p> <p>6.3 Pronari ose operatori i SAP-it mund ta operojë mjetin ajror vetëm nëse është në mënyrë të arsyeshme i bindur se fluturimi mund të kryhet në mënyrë të sigurt dhe se gjatë fluturimit nuk do të dëmtohen persona të tjerë</p>	<p>from pilot and personnel required for flying;</p> <p>c) Class III - is an inhabited area with constructions or facilities primarily intended for habitation, business or recreation (apartment buildings, apartment houses, schools, offices, parks, etc.);</p> <p>d) Class IV - is densely populated area of narrow urban zones (downtown, gatherings of a large number of people, etc.).</p> <p style="text-align: center;">Article 6 General operating conditions for UAS</p> <p>6.1 The owner or operator of an UAS during the flight, shall maintain the UAS within 120 m. above the ground level.</p> <p>6.2 The owner or operator of an UAS shall be responsible that the flights shall be performed in accordance with the present Regulation.</p> <p>6.3 The owner or operator of an UAS may only operate the aircraft if reasonably satisfied that the flight can safely be performed and that other persons and property are not harmed during the flight and ensure not to interfere</p>	<p>osim pilota i osoblja potrebnog za letenje;</p> <p>c) Klasa III - je naseljeno područje sa zgradama ili objektima prvenstveno namenjenim za stanovanje, poslovanje ili rekreaciju (stambene zgrade, stambene kuće, škole, kancelarije, parkovi itd.);</p> <p>d) Klasa IV - je gusto naseljeno područje uskih urbanih zona (centar grada, okupljanja velikog broja ljudi itd.).</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Opšti uslovi rada za SBL</p> <p>6.1 Vlasnik ili operater SBL tokom leta mora da održava bespilotnu letelicu unutar 120 m iznad nivoa tla.</p> <p>6.2 Vlasnik ili operater SBL je odgovoran da se letovi obavljaju u skladu sa ovim pravilnikom.</p> <p>6.3 Vlasnik ili operater SBL može upravljati vazduhoplovom samo ako je razumno uveren da se let može bezbedno obaviti i da druge osobe i imovina neće biti povređeni tokom leta i ako osigura da neće ometati javni red i</p>
--	---	--

<p>apo pasuri, si dhe duke siguruar që të mos cenohet rendi dhe siguria publike.</p> <p>6.4 Pronari ose operatori i SAP-it duhet të mbajë kontakt të drejtpërdrejtë vizual, pa ndihmë teknike, me mjetin ajror, të mjaftueshëm për të monitoruar trajektoren e fluturimit në raport me mjete të tjera ajrore, persona, automjete dhe struktura, me qëllim të shmangies së përplasjeve.</p> <p>6.5 Pronari ose operatori i SAP-it duhet të sigurojë që sistemi të mirëmbahet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit dhe që gjendja e sistemit të kontrollohet përpara kryerjes së fluturimit.</p> <p>6.6 Para kryerjes së fluturimit, pronari ose operatori i SAP-it është përgjegjës që fluturimi të planifikohet, me qëllim të përcaktimit të llojit të hapësirës ajrore në të cilën do të kryhet fluturimi dhe që fluturimi të ekzekutohet brenda asaj klase, si dhe që këto informata të jenë në dispozicion të njësisë së kontrollit të trafikut ajror për komunikim të mundshëm, nëse kërkohet.</p> <p>6.7 Transporti i mallrave dhe pasagjerëve me SAP është i ndaluar.</p> <p>6.8 Operimi me SAP, si dhe mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i imazheve ose të dhënave të tjera, i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve në</p>	<p>with the public order and security.</p> <p>6.4 The owner or operator of an UAS shall maintain direct, unaided visual line-of-sight with the aircraft sufficient to monitor its flight path in relation to other aircraft, persons, vehicles and structures for the purpose of avoiding collisions.</p> <p>6.5 The owner or operator of UAS shall ensure that the system is maintained in accordance with the manufacturer's instructions and that the system's status is inspected before a flight is carried out.</p> <p>6.6 Before a flight is carried out, the owner or operator of UAS is responsible that the flight shall be planned to determine which type of airspace the flight will be carried out and executed in that class and shall be available to air traffic control unit for possible necessary communication.</p> <p>6.7 Transport of goods and passengers with UAS is prohibited.</p> <p>6.8 The operation of UAS as well as collection, storage and use of images or other data is subject to the applicable data protection</p>	<p>bezbednost.</p> <p>6.4 Vlasnik ili operater SBL mora održavati direktnu, nesmetanu vizuelnu liniju vida sa vazduhoplovom dovoljnu za praćenje njegove putanje leta u odnosu na druge vazduhoplove, osobe, vozila i objekte u svrhu izbegavanja sudara.</p> <p>6.5 Vlasnik ili operater SBL mora da obezbedi da se sistem održava u skladu sa uputstvima proizvođača i da se status sistema proverri pre nego što se let izvrši.</p> <p>6.6 Pre nego što se let izvrši, vlasnik ili operater SBL je odgovoran da let bude isplaniran kako bi se utvrdilo u kom tipu vazdušnog prostora će se let obavljati i izvoditi u toj klasi, i da bude dostupan jedinici kontrole letenja za eventualno potrebnu komunikaciju.</p> <p>6.7 Prevoz robe i putnika sa SBL-om je zabranjen.</p> <p>6.8 Upravljanje SBL, kao i prikupljanje, skladištenje i korišćenje slika ili drugih podataka podleže važećim zakonima i</p>
---	---	--

<p>fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë në Republikën e Kosovës; prandaj, pronari ose operatori i SAP-it duhet të sigurojë përputhshmërinë me të gjitha kërkesat ose përjashtimet e zbatueshme.</p> <p>6.9 Në asnjë rrethanë, pa autorizim paraprak me shkrim nga subjektet përkatëse, pronari ose operatori i SAP-it nuk guxon të angazhohet në fotografimin ajror ose vëzhgimin vizual të ndërtesave qeveritare të Kosovës, KFOR-it, EULEX-it, zyrave përfaqësuese të organizatave ndërkombëtare dhe misioneve diplomatike të huaja në Kosovë, apo të ndonjë agjencie tjetër të zbatimit të ligjit ose të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke përfshirë aktivitetet, pajisjet, kampet, bazat, zyrat dhe ndërtesat e tyre.</p> <p>6.10 Për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes, shkeljet e paragrafit 6.9 të këtij neni rezultojnë në sekuestrimin dhe ekzaminimin e SAP-it, duke përfshirë të gjitha pajisjet përkatëse për mbledhjen dhe transmetimin e imazheve, komunikimin, navigimin dhe kontrollin nga Policia e Kosovës ose nga KFOR-i. Pronari ose operatori mund t'i nënshtrohet masave shpesh të vendosura nga agjencitë përkatëse vendore dhe ndërkombëtare (KFOR) në Kosovë, duke përfshirë sekuestrimin e SAP-it dhe pajisjeve përkatëse.</p> <p>6.11 Përveç paragrafit 6.10 të këtij neni, AAC</p>	<p>and privacy laws and regulations in the Republic of Kosovo, therefore the owner or operator of the UAS should ensure that they are complying with any such applicable requirements or exemptions.</p> <p>6.9 Under no circumstances, without prior written authorization by the intended subjects, shall the owner or operator of a UAS engage in taking of aerial photographs or the visual observation of Kosovo governmental buildings, KFOR, EULEX, representation offices of international organizations and foreign diplomatic missions in Kosovo, or any other law enforcement agencies or Kosovo Security Forces, including their activities, equipment, camps, bases, offices and buildings.</p> <p>6.10 For safety and security issues, violations of paragraph 6.9 of this Article, shall result in the seizure and examination of the UAS including all related image collection and transmission, communication, navigation, and control equipment by Kosovo Police or by KFOR. The owner or operator may be subjected to additional measures imposed by appropriate local and international agencies (KFOR) in Kosovo, including the seizure of the UAS and related equipment.</p> <p>6.11 In addition to the paragraph 6.10 of this</p>	<p>propisima o zaštiti podataka i privatnosti u Republici Kosovo, stoga vlasnik ili operater bespilotnih letelica treba da osigura da se pridržavaju svih takvih važećih zahteva ili izuzeća.</p> <p>6.9 Ni pod kojim okolnostima, bez prethodne pismene dozvole predviđenih subjekata, vlasnik ili operater SBL ne sme se baviti snimanjem iz vazduha ili vizuelnim posmatranjem zgrada vlade Kosova, KFOR-a, EULEKS-a, predstavništava međunarodnih organizacija i stranih diplomatskih misija na Kosovu, ili bilo kojih drugih agencija za sprovođenje zakona ili Kosovskih bezbednosnih snaga, uključujući njihove aktivnosti, opremu, kampove, baze, kancelarije i zgrade.</p> <p>6.10 Zbog pitanja bezbednosti i sigurnosti, kršenje stava 6.9 ovog člana rezultiraće zaplenom i pregledom bespilotne letelice, uključujući svu povezanu opremu za prikupljanje i prenos slika, komunikaciju, navigaciju i kontrolu, od strane Kosovske Policije ili KFOR-a. Vlasnik ili operater može biti podvrgnut dodatnim merama koje nameću odgovarajuće lokalne i međunarodne agencije (KFOR) na Kosovu, uključujući zaplenu SBL i pripadajuće opreme.</p> <p>6.11 Pored stava 6.10 ovog člana, ACV može</p>
---	---	---

<p>mund të shqiptojë gjobë ndaj pronarëve/operatorëve të SAP-it, në rast se shkeljet e përshkruara raportohen në AAC nga KFOR-i ose Policia e Kosovës.</p> <p>6.12 Aksidentet ose incidentet që rezultojnë me lëndime të personave ose kafshëve, apo me dëme në pasuri në tokë ose në ajër, duhet të raportohen në AAC dhe në Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA).</p> <p>6.13 Pronari ose operatori i SAP-it është përgjegjës që të dhënat e fluturimeve të evidentohen në një regjistër fluturim ose dokument ekuivalent. Të dhënat duhet të përfshijnë emrin e pilotit në distancë, datën, zonat e ngritjes dhe uljes së SAP-it, kohëzgjatjen e fluturimit, kohën totale të fluturimit, llojin e aktivitetit dhe nënshkrimin e pronarit ose operatorit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Regjistrimi nga AAC-ja</p> <p>7.1 Pronari ose operatori i SAP-it nuk duhet të operojë me SAP pa regjistrimin paraprak të lëshuar nga AAC-ja. Pronari ose operatori duhet të aplikojë për regjistrim duke përdorur formularin e regjistrimit të bashkangjitur si Shtojca 1 e kësaj Rregulloreje.</p>	<p>Article, the CAA may impose fines to the owners/operators of UAS in case the violations described herein are reported to the CAA by KFOR or Kosovo Police.</p> <p>6.12 Accidents or incidents which result in the injury of persons or animals or damage to property on the ground or in the air shall be reported to the CAA and Aeronautical Accident and Incident Investigations Commission (AAIIC).</p> <p>6.13 The owner or operator of the UAS is responsible that the information of the flights shall be noted in a logbook or equivalent document. The information shall consist of name of the remote pilot, date, take-off and landing areas of UAS, flight time, total flight time, type of activity and the signature of the owner or operator.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 CAA registration</p> <p>7.1 The owner or operator of UAS shall not operate UAS without prior registration issued by the CAA. The owner or operator shall apply for registration using the registration form attached as Annex 1 to this Regulation.</p>	<p>izreći kazne vlasnicima/operaterima SBL u slučaju da KFOR ili Kosovska Policija prijave ACV prekršaje opisane ovde.</p> <p>6.12 Nesreće ili incidenti koji dovedu do povreda lica ili životinja ili oštećenja imovine na zemlji ili u vazduhu moraju se prijaviti ACV i Komisiji za istraživanje vazduhoplovnih nesreća i incidenata (AAIIC).</p> <p>6.13 Vlasnik ili operater SBL je odgovoran da se informacije o letovima zabeleže u dnevniku leta ili ekvivalentnom dokumentu. Informacije moraju da sadrže ime daljinskog pilota, datum, područja poletanja i sletanja SBL, vreme leta, ukupno vreme leta, vrstu aktivnosti i potpis vlasnika ili operatera.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Registracija pri ACV</p> <p>7.1 Vlasnik ili operater SBL ne sme da upravlja bespilotnom letelicom bez prethodne registracije koju izdaje ACV. Vlasnik ili operater podnosi zahtev za registraciju koristeći obrazac za registraciju koji je priložen kao Aneks 1 ove Uredbe.</p>
---	--	---

<p>7.2 Aplikimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dorëzohet të paktën pesë (5) ditë pune para fillimit të operimeve dhe duhet të përmbajë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) emrin dhe adresën e aplikantit; (b) kopjen e letërnjoftimit, ose në rastin e shtetasve të huaj, kopjen e pasaportës; (c) certifikatën mbi dënimet penale; (d) përshkrimin e operimeve të fluturimit dhe zonave; (e) llojin e SAP-it që duhet të përdoret për operimin e fluturimit; (f) fotografitë e SAP-it që do të përdoren; (g) manualin e fluturimit ose manualin e përdoruesit; (h) Deklaratën e nënshkruar sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje. <p>7.3 AAC-ja mund, para regjistrimit, të kryejë mbikëqyrje direkte të operatorit të SAP-it dhe të kërkojë fluturime demonstrative.</p> <p>7.4 AAC-ja duhet të koordinojë me KFOR-in, Policinë e Kosovës dhe çdo autoritet tjetër shtetëror të domosdoshëm, sipas rastit, para regjistrimit të një SAP-i.</p> <p>7.5 Regjistrimi i SAP-it është i vlefshëm për katër vite.</p>	<p>7.2 The application as referred to in paragraph 1 of this Article shall be submitted at least five (5) working days before the start of operations and shall contain:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) name and address of the applicant; (b) copy of the ID, or in the case of foreign nationals, copy of the Passport; (c) certificate on Criminal Convictions; (d) description of flight operations and areas; (e) type of UAS that shall be used for flight operation; (f) photos of UAS to be used; (g) flight manual or user manual; (h) signed Declaration as referred to in Article 10 of this Regulation. <p>7.3 The CAA may, prior to registration, conduct direct supervision of the UAS operator and request demonstration flights.</p> <p>7.4 The CAA shall coordinate with KFOR, Kosovo Police and any other necessary State Authorities, as appropriate, before registering an UAS.</p> <p>7.5 UAS registration is valid for four years.</p>	<p>7.2 Zahtev iz stava 1. ovog člana podnosi se najmanje pet (5) radnih dana pre početka rada i sadrži:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) ime i adresa podnosioca zahteva; (b) kopiju lične karte, ili u slučaju stranih državljana, kopiju pasoša; (c) potvrda o krivičnim osudama; (d) opis letačkih operacija i područja; (e) tip bespilotnog letelice koji će se koristiti za letenje; (f) fotografije bespilotnih letelica koje će se koristiti; (g) priručnik za letanje ili uputstvo za upotrebu; (h) potpisana izjava kako je navedeno u članu 10. ove uredbe. <p>7.3 ACV može, pre registracije, vršiti direktan nadzor nad operaterom bespilotnih letelica i zahtevati demonstrativne letove.</p> <p>7.4 ACV će koordinirati sa KFOR-om, Kosovskom policijom i svim drugim potrebnim državnim organima, po potrebi, pre registracije SBL.</p> <p>7.5 Registracija SBL važi četiri godine.</p>
--	--	--

<p>7.6 Për regjistrimin e SAP-it, pronari ose operatori duhet të paguajë këtë tarifë në AAC:</p> <p>a) për Kategorinë A1 të SAP-it, tarifën prej 25 €;</p> <p>b) për Kategorinë A2 të SAP-it, tarifën prej 50 €;</p> <p>c) për Kategorinë A3 të SAP-it, tarifën prej 125 €;</p> <p>d) për Kategorinë 4 të SAP-it, tarifën prej 250 €.</p> <p>7.7 SAP duhet të regjistrohet në regjistrin e SAP-it, i cili menaxhohet nga AAC.</p> <p>7.8 SAP që janë të regjistruara në një shtet të huaj nuk kanë nevojë të regjistrohen në AAC. Megjithatë, pronari/operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm që do të kërkohet nga AAC. Në çdo rast, dispozitat e nenit 8 zbatohen gjithashtu për SAP me regjistrim të huaj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Kushtet e operimit për SAP</p> <p>8.1 Pronari ose operatori i SAP-it duhet të paraqesn kërkesën të paktën tre (3) ditë pune</p>	<p>7.6 For UAS registration, the owner or the operator shall pay the following fee to the CAA:</p> <p>a) for UAS Category A1, a fee of 25 €;</p> <p>b) for UAS Category A2, a fee of 50 €;</p> <p>c) for UAS Category A3, a fee of 125 €;</p> <p>d) for UAS Category 4, a fee of 250 €.</p> <p>7.7 The UAS shall be entered in the UAS register, which is managed by the CAA.</p> <p>7.8 The UAS which are registered in foreign country do not need to be registered with the CAA. However, the owner/operator shall submit the necessary which will be requested by CAA. In any case the provisions of Article 8 shall also apply to UAS with foreign registration.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Operating conditions for UAS</p> <p>8.1 The owner or operator of UAS shall submit a request at least three (3) working days in</p>	<p>7.6 Za registraciju SBL, vlasnik ili operater je dužan da plati sledeću naknadu ACV:</p> <p>a) za SBL kategorije A1, naknada od 25 €;</p> <p>b) za SBL kategorije A2, naknada od 50 €;</p> <p>c) za SBL kategorije A3, naknada od 125 €;</p> <p>d) za SBL kategorije 4, naknada od 250 €.</p> <p>7.7 SBL mora biti uneta u registar bespilotnih letelica, kojim upravlja ACV.</p> <p>7.8 SBL koje su registrovane u stranoj zemlji ne moraju biti registrovane kod ACV. Međutim, vlasnik/operator je dužan da dostavi potrebnu dokumentaciju koju će zahtevati ACV. U svakom slučaju, odredbe člana 8 primenjivaće se i na SBL sa stranom registracijom.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Operativni Uslovi za SBL</p> <p>8.1 Vlasnik ili operater SBL mora podneti zahtev najmanje tri (3) radna dana unapred</p>
---	---	--

<p>më herët në Shërbimin e Informatave Aeronautike ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror (KANS). për leje operimi dhe koordinim civil-ushtarak.</p>	<p>advance to the Aeronautical Information Service (AIS) of the Kosovo Air Navigation Services (KANS) for the permission of operation and civilian-military coordination.</p>	<p>Službi za vazduhoplovne informacije (SVI) Kosovske službe vazdušne navigacije (KSVN) za dozvolu za rad i civilno-vojnu koordinaciju.</p>
<p>8.2 Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni i dorëzohet SHIA-së duke përdorur formularin e bashkëngjitur si Shtojca 3 e kësaj Rregulloreje.</p>	<p>8.2 The request referred to in paragraph 1 of this Article shall be submitted to AIS using the form appended as Annex 3 to this Regulation</p>	<p>8.2 Zahtev iz stava 1. ovog člana podnosi se SVI-u koristeći obrazac koji je priložen kao Aneks 3 ovog pravilnika</p>
<p>8.3 Kërkesë së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni i bashkëngjitet regjistrimi përkatës i lëshuar nga AAC.</p>	<p>8.3 The request defined in paragraph 2 of this Article, shall have attached the relevant registration issued by the CAA.</p>	<p>8.3 Zahtevu iz stava 2. ovog člana, mora biti priložena odgovarajuća registracija koju je izdala ACV.</p>
<p>8.4 Pronari ose operatori i SAP-it nuk duhet të operojë ne SAP në:</p>	<p>8.4 The owner or operator of UAS shall not operate the UAS at:</p>	<p>8.4 Vlasnik ili operater SBL ne sme da upravlja bespilotnom letelicom u:</p>
